



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1304/2 Prot.

Tiranë, më 16 / 09 / 2019

V E N D I M

Nr. 123, Datë 16 / 09 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.104, datë 02.09.2019, të A. I, kundër Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a, me objekt pretendimin për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”².

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nga parashtrimet dhe dokumentacioni i sjellë, rezulton se subjekti ankues, A. I ka qenë në marrëdhënie pune pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a deri me datë 07.05.2019, në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Operimit të Sistemit.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Me “*çdo shkak tjetër*”, ankuesi nënkupton ankimin që ka paraqitur tek Portali i Bashkëqeverisjes”, për OST sh.a.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Nëpërmjet shkresës me nr.3046 prot., datë 07.05.2019 të Administratorit të OST sh.a është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, bazuar në parashikimet e nenit 153, të Kodit të Punës.

Ankuesi shprehet se, duke e konsideruar këtë vendim haptazi të pabazuar, të paarsyetuar dhe në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës, i është drejtuar Platformës së Bashkëqeverisjes, nëpërmjet portalit për shërbimet ndaj qytetarëve (e-Albania).

Në vijim ai citon se: *“Në kërkesën time drejtuar Platformës, jam ndalur në faktin që OST sh.a nuk ka zbatuar dhe përmbushur asnjë nga detyrimet që rrjedhin nga parashikimet e Kodit të Punës, Kontratës Individuale të Punës dhe Kontratës Kolektive, duke theksuar që titullari i Shoqërisë është në shkëlqje të hapur të drejtave të punëmarrësit. Në momentin që kam ushtruar të drejtën për t’u ankuar pranë këtij Portali, nga ana e OST sh.a jam përballur me një sulm diskriminues që lidhet jo vetëm me trajtimin e pabarabartë por dhe me privimin nga e drejta e përfitimit të shpërblimit/pagesës. Ushtrimi i të drejtës së ankimimit tek Portali është baza për mohimin e trajtimit të barabartë në marrëdhëniet e punës dhe privimin nga të drejtat ekonomike. Si pasojë e këtij ankimimi kam marrë përgjigje kërcënime të drejtëpërdrejta në lidhje me vështirësinë që do has unë si person për punësim në të ardhmen”.*

Ankuesi shprehet se me datë 9 Korrik 2019 i është drejtuar OST sh.a shkresërisht mbi konstatimin se për periudhën nga muaji Qershor 2019, ende nuk i ishte njohur e drejta në lidhje me përfitimin financiar për largimin nga puna dhe për pasojë nuk ishin kryer pagesat siç përcaktonte neni 57/1 i Kontratës Kolektive të Punës, duke i mohuar një të drejtë të ligjshme. A.I sqaron se, në mungesë të një përgjigjeje nga ana e OST sh.a i është drejtuar sërish nëpërmjet portalit e-Albania, Platformës së Bashkëqeverisjes, ku ka parashtruar kërkesën që i kishte adresuar OST sh.a. Po ashtu, ai informon se, në përgjigjen e dhënë në Portalin e Bashkëqeverisjes lidhur me ankimin e tij, OST sh.a ka parashtruar se: *“...Janë duke u verifikuar (Nga Drejtoria Ligjore) të gjitha pretendimet sipas të cilave A .I vlerëson se shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënieve të tij të punës janë të paarsyeshme si dhe çdo kusht tjetër sipas të cilit OST sh.a është e detyruar të përmbush parashikimet e nenit 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës, ku parashikohet shprehimisht: “Në momentin më të parë të përfundimit të këtij procesi, OST sh.a do të finalizojë përgjigjen për z.I”.*

Në ankesën depozituar pranë KMD-së, ankuesi shprehet se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me punonjës të tjerë në kushte të ngjashme ose të njëta, të cilët kanë mbajtur pozicione pune ndaj të cilëve aplikohet ndalimi pas përfundimit të marrëdhënies së punës, për të cilët OST sh.a ka ofruar kompensim financiar, ndryshe nga sa kanë bërë me të.

Kështu, ai ka cituar nenin 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës, i cili ka parashikuar specifikisht se: “1). Punonjësit që mbajnë pozicionet e punës sipas Aneksit 1, pjesë e kësaj Kontrate, nuk do të punësohen tek ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike, për një periudhë një vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies së punës me OST sh.a. 2). Gjatë periudhës së ndalimit, punëdhënësi i ofron punëmarrësit një kompensim financiar të përmuajshëm, të barabartë me pagën që ai ka në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës, për një periudhë maksimale një vjeçare. Kompensimi financiar nuk jepet ose ndërpritet kur vërtetohet se punëmarrësi ka hyrë në marrëdhënie të re pune. Kur paga është e ndryshueshme kompensimi financiar llogaritet mbi bazën e pagës mesatare të vitit të mëparshëm dhe indeksuohet. 3). Ndalimi nuk zbatohet kur punëdhënësi zgjidh kontratën për shkaqe të pajustificuara ose kur punëmarrësi zgjidh kontratën për një shkak të justifikuar që lidhet me punëdhënësin”.

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues ka kërkuar konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe marrjen e masave për përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga neni 57/1 i Kontratës Kolektive të Punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Bazuar në deklaratimet dhe në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, konstatohet se:

- Nëpërmjet shkresës me nr.3046 prot., datë 07.05.2019 të OST sh.a, ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.
- Në kontekst të sa mësipër, me datë 14.05.2019 ankuesi ka paraqitur një ankesë tek Platforma e Bashkëqeverisjes.
- Me datë 14.06.2019 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet këtij portali ka njohur z.I me përgjigjen e OST sh.a, e cila parashtron arsyet për të cilat ka ardhur përfundimi i marrëdhënieve të punës me ankuesin.
- Me datë 09.07.2019 ankuesi i është drejtuar shkresërisht OST sh.a lidhur me mosrespektimin nga ana e saj të nenit 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës, duke cituar se, kishte konstatuar se për muajin Qershor 2019 nga ana OST sh.a nuk i është njohur e drejta e pagesës sipas përcaktimit të nenit sipërcituar. Ai ka kërkuar që nga ana e OST sh.a të përmbusheshin detyrimet që buronin nga ky nen, duke kryer në favor të tij pagesat për periudhën një vjeçare.

- Nëpërmjet e-mailit të datës 15.08.2019 ankuesi i është ridrejtuar sërisht Platformës së Bashkëqeverisjes, duke specifikuar se nga ana e OST sh.a ende nuk është përmbushur detyrimi i nenit 57/1 i Kontratës Kolektive të Punës.

Referuar kronologjisë dhe përmbajtjes së ankimeve të bëra nga ankuesi në Portalin e Bashkëqeverisjes, vërehet se, ai aty ka ngritur pretendimin se OST sh.a nuk ka përmbushur parashikimet e nenit 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës, lidhur me pagesën një vjeçare që atij duhej ti akordohej dhe nuk ka pretenduar që ai po diskriminohet nga ana e OST sh.a.

Nga ana e OST sh.a ankuesi është informuar se po verifikohen (Nga Drejtoria Ligjore) të gjitha pretendimet sipas të cilave ai ka vlerësuar se shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënieve të tij të punës janë të paarsyeshme si dhe çdo kusht tjetër sipas të cilit OST sh.a është e detyruar të përmbush parashikimet e nenit 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës.

“Çdo shkak tjetër” është shkak i pretenduar diskriminimi nga A. I, të cilin ai e lidh me faktin se moszbatimi i nenit 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës, ka ardhur si pasojë e ankimit të tij në Portalin e Bashkëqeverisjes.

Në kontekst të sa mësipër, në interpretim të parashikimeve ligjore që LMD-së, lidhur me faktin që ankuesi ka pretenduar se është viktimizuar për shkak të ankimit në këtë Portal, Komisioneri sqaron se,

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

“Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Pika 8, e këtij neni ka parashikuar shprehimisht se, “Viktimizimi” është trajtimi i pafavorshëm ose pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a procedimi që synon zbatimin e barazisë dhe në thelb ka pretendimin për diskriminim nga ana e institucionit publik apo privat.

Në rastin konkret, ankimin në Portal ankuesi e ka bërë për moszbatim të nenit 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës⁴, dhe ky nuk mund të ketë të shërbyer në vetvehte si “shkaku” që ka pasqjellë trajtimin e tij diskriminues.

Në konkluzion të sa mësipër, Komisioneri konstaton se ankimi në Portal, si shkak i pretenduar nga ankuesi për viktimizim, nuk do të merret në konsideratë, pasi ai nuk është ankuar në Portal për shkelje të Ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, por për moszbatim të nenit 57/1 të Kontratës Kolektive të Punës.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për trajtim të pabarabartë me E. A, Komisioneri sqaron se një pretendim i tillë nuk mund të merret në shqyrtim, përse kohë ankuesi nuk ka një shkak të provuar, si pasojë e të cilit të ketë ardhur dhe trajtimi i tij i pabarabartë.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁴ Referuar pretendimit për mospagesën një vjeçare nga OST sh.a

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së A. I, për shkak se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja djeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Çdo shkak tjetër